

VENDIM
Nr.1150, datë 25.11.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1694, DATË 24.12.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2009, NË
MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1694, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve buxhetorë për vitin 2009, për ministrinë dhe institucionet qendrore, bëhet 89 879 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

b) Numrit të punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i shtohen 2 (dy) veta.

c) Numrit të punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, i shtohen 2 (dy) veta.

ç) Numrit të punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, i shtohen 2 (dy) veta.

d) Numrit të punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, i pakësohen 5 (pesë) veta.

dh) Numrit të punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Këshillin e Ministrave, i shtohen 5 (pesë) veta, për Drejtorinë e Politikave të Postë-Telekomunikacionit.

e) Në numrin e punonjësve, miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, korrigjohet numri i punonjësve të bordeve të kullimit dhe bëhet 646 (gjashtëqind e dyzet e gjashtë) veta. Numri i përgjithshëm i punonjësve të kësaj ministrie nuk ndryshon.

2. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet e përmendura në shkronjat “b”, “c” “ç”, “d” “dh” e “e”, të pikës 1 të këtij vendimi, për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Ministritë/institucionet	Viti 2009
3	KRYEMINISTRIA	148
4	MINISTIRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, NGA E CILA:	804
	- DREJTORIA E STANDARDEVE	18
	- SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR	135
	- DR.METEREOLOGJISË E KALIBRIMIT	110
	- QENDRA KOMBËTARE E LICENCIMIT	35
	- QENDRA KOMBËTARE E APLIKIMIT TË ENERGJISË	18
5	MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT NGA E CILA:	2.198
	- BORDET E KULLIMIT	646
	- AGJENCIA E PAGESAVE	86

6	MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE TRASPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT	1.358
10	MINISITRIA E FINANCAVE, NGA E CILA:	3206
	- DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE	1.062
	- DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE	1.616
	- DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE	26
	- AGJENCIA E LOJËRAVE TË FATIT	25
11	MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS	39.231
	- PARAUNIVERSITARE	38241
12	MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE	1.105
13	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	3530
14	MINISTRIA E DREJTËSISË, NGA E CILA:	5026
	- AVOKATI I SHTETIT	55
	- ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURIVE	550
	- AGJENCIA KOMB. KTHIM. KOMPENSIM PRONA	150
	- SHËRBIMI I PROVËS	50
15	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME	188
	AMBASADA DHE PËRFAQËSITË	428
16	MINISTRIA E BRENDSHME, NGA E CILA:	13305
	- DREJTORIA E REZERVAVE TË SHTETIT	100
17	MINISTRIA E MBROJTJES	11779
18	SHËRBIMI INFORMATIV SHTETËROR	950
20	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE	155
22	AKADEMIA E SHKENCAVE	31
25	MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE	1.434
26	MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE	1.401
31	AGJENCIA TELEGRAFIKE SHQIPTARE	82
50	INSTITUTI I STATISTIKËS	169
57	QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË	10
59	INSTITUTI I REHABILITIMIT TË TË PËRNDJEKURVE POLITIKE	25
78	MINISTRIA E INTEGRIMIT	77
82	KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT	6
87	INSTITUCIONE TË TJERA QE VERITARE, NGA E CILA:	103
	- DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR	38
	- AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK	36
	- KOMITETI SHTETËROR I MINORITETEVE	9
	- AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT	20
	TOTAL, NUMRI I PUNONJËSVE	86 749
	NUMRI I PUNONJËSVE NË INSTITUCIONET E PAVARURA	3 130
	TOTAL NUMRI PUNONJËSVE BUXHETORE	89 879